

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BO "Muhoplus LTD"sh.p.k &"Az Trading"sh.p.k**

* * *

Procedura e prokurimit: "**E Hapur**"

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-07961-02-14-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Blerje automjete teknologjike**"

Fondi limit: **80,497,293,33** (tetëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr:7 datë 18.02.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "**TIMAK**" sh.p.k

L62030020B

Vlera 73,500,000 (shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.

2. BO "**MuhoplusLTD**" & "**AZ TRADING**" sh.p.k

L52317046G&L81515016F

Vlera 78,484,000(shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "**TIMAK**" sh.p.k

L62030020B

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "**TIMAK**"sh.p.k

1.Çmimi total i ofertës pa tvsh = 73,500,000(shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë)lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për

“Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose autorizim i distributorit zyrtar i autorizuar prej prodhuesit per mallrat e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, ebsite kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Gjatë shqyrtimit të autorizimit të paraqitur nga operatori ekonomik vëren se autorizimi vertet është në gjuhën shqipe por është leshuar nga një kompani e huaj turke me qendër në Ankara dhe përkatësisht Nurmak Arac Ustu.

Së pari kompania turke nuk është një kompani shqiptare si dhe nuk ka degë të saj në territorin e Republikës së Shqipërisë e cila mund të lëshonte një dokument në gjuhën zyrtare, pra në gjuhën shqipe.

Vlen të theksojmë se, përderisa kompania Nurmak Arac Ustu është një kompani e huaj e cila operon në një shtet të huaj (Turqi) detyrimisht autorizimi duhej normalisht të paraqitej në gjuhë zyrtare të vendit të saj ku është e regjistruar e zhvillon aktivitetet, të apostilohej dhe paskëtaj duhej të përkthehej nga një përkthyes zyrtar i njohur nga Ministria e Drejtësisë si dhe të vertetohej perkthimi nga gjuha turke në gjuhën shqipe pranë një noteri publik.

Operatori nuk ka paraqitur asnjë dokument që të dëshmonte se lëshuesi i autorizimit (një kompani e huaj) është njohës i gjuhës shqipe, çka do të thotë se lëshuesi i autorizimit nuk kupton detyrimisht përmbajtjen e autorizimit që ka leshuar, çka nuk e bind AK se operatori dëshmon plotësimin e këtij kriteri për kualifikim. Pra autorizimi i paraqitur nga kompania turke në gjuhën shqipe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm .

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.03.2019**

Ankesa: **PO**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BO **”MuhoplusLTD” & “AZ TRADING” sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 78,484,000 (shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.03.2019**

Ankesa: **PO**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga operatori ekonomik “**Timak**” shpk hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.5567, Prot. datë 15.03.2019 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “**Blerje automjete teknologjike**” .

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 3251/4 Prot. dt. 15.03.2019, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Prot. 3251/5 datë 15.03.2019 , u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “**Timak**” shpk , ka konkluduar sa më poshtë:

Janë marrë parasysh pjesërisht pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “**Timak**” shpk . Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatorëve Ekonomik “**Timak**” shpk me ane të shkresës Nr. 5567/1 datë 20.03.2019 (administruar në dosjen e prokurimit).